



Prishtinë: 10.07.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1173_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1938_05_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **10.06.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Sh. G. nga fshati Dardhishtë, Kastriot, me shifër të konsumatorit DPR 90095688, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1938_05_19** i datës 10.05.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 10.06.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin nr.73536426 ka qenë e verifikuar nga qendra e kalibrimit dhe se gabimi në matje ka qenë +0.01% e që është brenda kufijve të lejuar të matjes. KESCO në ankesë ka theksuar se vendimi i organit të shkallës së parë bazohet në mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike si dhe shpenzimin e njëjtte sipas viteve dhe se kjo nuk është bindëse pasi që në periudhën 07/08/2015 konsumatori nuk ka fare shpenzim, pastaj në periudhën 07, 08, 09, 10/2016 ka rritje të shpenzimit, në vitin 2017 ka shpenzim, por nuk ka shpenzim në periudhën 09/10/2017 dhe në periudhën 07,08,09,10/2018 ka shpenzim. KESCO në ankesë ka theksuar se shpenzimi i periudhës 07/08/09/10/2014 është më i madh por që nuk është si rezultat i gabimit në matje por është shpenzim real dhe se bazohet në raportin e kalibrimit. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1938_05_19 i datës 10.05.2019 për konsumatorin Sh.G. me shifër DPR – 90095688.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se gjendja e shpenzimit në njehsorin nr.73536426 është verifikuar nga qendra e kalibrimit dhe se njehsori elektrike është brenda kufijve të lejuar të matjes, Bordi i ZRRE-së thekson se ka analizuar me kujdes procesverbalin e tillë të kalibrimit dhe se thekson se pas ndërrimit të njehsorit elektrike, punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 31.05.2016 kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes së njehsorit elektrik nr.73536426 dhe gjatë shqyrtimit kanë konstatuar se: *“njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik nuk është i dëmtuar nga ana e jashtme, blloibat (vulat) i ka në rregull, si dhe gabimi në matje është +0.01%. Po ashtu kanë evidentuar Vërejtjen: Njehsorit elektrik herë pas here i paraqitet FF.00004001”*. Pra vet punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë theksuar se njehsori elektrik nuk është në rregull edhe përkundër të rezulton se nuk ka gabime në matje, andaj si i tillë KESCO dhe KEDS është dashur të analizojnë më saktë ankesën e konsumatorit dhe jo vetëm të thirren se njehsori elektrik nr.73536426 është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe pa bërë analiza më detale të lëndës së konsumatorit.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KESCO-s se vendimi i DMK në ZRRE si organi i shkallës së parë brenda ZRRE është i bazuar vetëm në rrjedhën e energjisë elektrike, respektivisht në krahasimin e shpenzimeve, Bordi i ZRRE thekson se rrjedha e energjisë elektrike, respektivisht krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike para dhe par periudhës kontestuese, krahasimi i shpenzimeve të periudhave të njëjta sipas viteve, është një indikator mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve. Për këtë edhe si organi i shkallës së parë DMK në ZRRE ashtu Bordi i ZRRE ka bërë analizimin e shpenzimit të energjisë elektrike, për të parë se si ka rrjedhur energjia elektrike dhe gjatë analizës është konstatuar se konsumatori nga fillimi ka shpenzime shumë të ulëta të energjisë elektrike, përkatësisht në shumicën e periudhave kohore është faturuar vetëm me taksa për shkak të mos shpenzimit. Për më tepër Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike me dy njehsorët elektrik nr.73536426 dhe nr.63981605 dhe konstaton se vetëm për periudhat kontestuese ka ndryshim të madh të shpenzimeve. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike për periudhat e njëjta kohore të mëvonshme shpenzimet me njehsorin elektrik nr.63981605 për periudhën 07/2015 është 0 kWh, periudhën 08/2015 është 0 kWh, periudhën 09/2015 është 0 kWh, periudhën 10/2015 është 0 kWh, për periudhën 07/2016 është 3 kWh, periudhën 08/2016 është 62 kWh, periudhën 09/2016 është 196 kWh, periudhën 10/2016 është 2 kWh, për periudhën 07/2017 është 183 kWh, periudhën 08/2017 është 260 kWh, periudhën 09/2017 është 0 kWh, periudhën 10/2017 është 0 kWh, për periudhën 07/2018 është 147 kWh, periudhën 08/2018 është 311 kWh, periudhën 09/2018 është 0 kWh si dhe periudhën 10/2018 është 172 kWh. Përderisa shpenzimi i energjisë elektrike për periudhën korrik 2014 ka qenë 2,348 kWh, për periudhën gusht 2014 me shpenzim prej 1,506 kWh, për periudhën shtator 2014 me shpenzim prej 656 kWh, për periudhën tetor 2014 me shpenzim 1,368 kWh. Bazuar në këto analiza vërtetohet se konsumatori në periudhat kontestuese 07/08/09/10/2014 ka dallim të madh të shpenzimit të energjisë elektrike krahasuar me të gjitha periudhat e njëjta kohore, andaj shpenzimet energjisë elektrike të periudhës 07/08/09/10/2014 nuk paraqesin shpenzime reale mujore. Për këtë Bordi i ZRRE-së se duke pasur parasysh dallimet e mëdha në shpenzime si dhe vërejtjen e evidentuar nga punëtorët e qendrës së kalibrimit në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr.73536426 konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë në ZRRE që për periudhën kontestuese konsumatorit duhet t'i anulohen këto fatura dhe i njëjti të faturohet me shpenzimet e periudhës 07/08/09/10/2016 me njehsorin e ri elektrik nr.63981605 është konstatim i saktë dhe si i tillë është i drejtë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Sh.G. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.